



Drejtoria për Arsim – Deçan

07 nr.5512

Deçan, dt.04.03.2014

Për shkak të anulimit të konkursit të dt.15.01.2014 nga ana e Komisionit dhe në bazë të dispozitave ligjore të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212,, Ligjit për Arsimin parauniversitar nr. 04/L-032, dispozitave të nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, si dhe konform nenit 2 pika 1-6 dhe nenit 3 pika 1-4 të Udhëzimit Administrativ nr.3/2009 nga MASHT, Drejtoria për Arsim në Deçan , shpallë dhe, **rishpallë** :

K O N K U R S I N

Për drejtor dhe zëvendës drejtor të këtyre Institucioneve të Arsimit publik në komunën e Deçanit

1. SH.F.M.U. “ **D r i t a** “ në Gramaqel
2. SH.F.M.U. “ **Dëshmoret e Vokshit** “ në Pobergjë
3. SH. F..M..U. “ **Lidhja e Prizrenit** “ në Deçan – zëvendës drejtor

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor në këto shkolla duhet ti plotësojnë këto kushte :

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Të kenë të kryer njërën nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT.
3. Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në Arsim.
4. **Të posedojnë këto dokumente :**
 - 4.1. Çertifikatën e lindjes.
 - 4.2. Diplomën e fakultetit të kryer.
 - 4.3. Dëshminë për përvojën e punës.
 - 4.4. CV-n sipas modelit të MASHT-it.
 - 4.5. Rekomandimin nga një person apo Institucion publik kredibil.
 - 4.6. Programin zhvillimor të Institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (më së shumti 5 faqe tekst me 30 rreshta të letrës së formatit A-4).
 - 4.7. Çertifikatat e trajnimeve të zhvilluara.
 - 4.8. Çertifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.

Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës, në pajtim me ligjet në fuqi dhe zgjatë 4 vjet.

Kandidatët e interesuar për konkurrim gëzojnë të drejtën e konkurimit në konkurs brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në Drejtoratin për Arsim në Deçan

Drejtori,
Qazim Maloku